

01-927

	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina	
---	--	---

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-75131/25 dt. 29.05.2025, të pronarit Avni Pestisha nga Prishtina, rruga “Pren Lleshi”, nr. 5, Bërrnicë, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtesën shtëpi banimi individual, ndërtuar në lagjen Bërrnicë e Epërme në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës, në procedurë të rregullt administrative, me datë 14.07.2025, lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

- I. I LEJOHET** pronarit Avni Pestisha nga Prishtina, sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-75131/25 dt. 29.05.2025, përdorimi i ndërtesës shtëpi banimi individual, me etazhitet P+1ET, e ndërtuar sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-136203/23 dt. 24.05.2024, në Lagjen Bërrnicë, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, Prishtinë konkretisht në parcelën kadastrale nr. 1278-2, ZK. Bërrnicë e Epërme.
- II.** Ndërtesa nga pika I. e këtij vendimi, ndodhet në rrugën “Pren Lleshi”, ku ka dalje hyrjen ndërtesa me numër: 5 në Prishtinë, dhe të njëjta do të përdoret dhe shfrytëzohet sipas destinimit të caktuar me leje ndërtimi dhe dokumentacionin ndërtimor, nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi të certifikatës së përdorimit.
- III.** Kjo Certifikatë do të shërbejë si bazë për regjistrimin e ndërtesës në evidencat e regjistrit kadastral.
- IV.** Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas Shtojca 5 e Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronari Avni Pestisha nga Prishtina, me kërkesën me 05 Nr. 391/02-75131/25 dt. 29.05.2025, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit për ndërtesën shtëpi banimi individual, me etazhitet P+1ET, të ndërtuar në Lagjen Bërrnicë, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban, Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelës kadastrale 1278-2, ZK. Bërrnicë e Epërme, sipas Vendimit të Lejes Ndërtimore 05 Nr. 351/02-136203/23 dt. 24.05.2024, të lëshuar nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit e Komunës së Prishtinës.

Paraprakisht Drejtoria e Inspeksionit-Sektori i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës, përmes shkresave zyrtare “Akt përcjellës”, me referencë 09 Nr. 391/02-41572/25 dt. 22.05.2025, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Raportet e Njoftimin mbi Inspektimit Final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspeksionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, kërkuesi ka prezantuar dokumentacionin sipas Shtojca 5 të Udhëzim Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/1.Inspektimi i themelit; Lista kontrolluese e Protokollit të

Inspektimit/2.a.1.Inspektimi i pjesëve strukture-Strukturave të betonit para instalimit të derdhjes; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.a.2.Inspektimi i pjesëve strukture-Strukturat e betonit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.c.Inspektimi i pjesëve strukture-Strukturat e çelikut; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/2.d.Inspektimi i pjesëve strukture-Strukturat e drurit; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/3.Inspektimi i instalimit elektrik; Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit/4.Inspektimi i instalimeve të ujit; Fotografi gjatë procesit të ndërtimit; Dëshminë mbi pagesën e lejes ndërtimore; Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve, certifikatat; Raportin e përfundimit të punëve të ndërtesës, nga udhëheqësi i vend ndërtimit Dardan Berisha; Raportin e përfundimit të punëve të arkitekturës, nga mbikëqyrësi Dardan Berisha; Raportin e përfundimit të punëve të konstruksionit, nga mbikëqyrësi Laurit Hafizi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, nga mbikëqyrësi Bujar Gashi; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve elektrike, nga mbikëqyrësi Fitim Gogaj; Raportin e përfundimit të punëve të instalimeve Makinerike, nga mbikëqyrësi Arbër Bajraktari; Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01, nga gjeodeti i licencuar për kryerjen e matjeve kadastrale Ibrahim Jonuzi me nr. të licencës 105;

Kjo drejtori, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, mendimit profesional të organit kompetent, Raportet e përfundimit të punëve, sipas fazave, dhe Raportin e Inspektimit Final, ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve të fazave të ndërtimit: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, konstatohet se punët janë zhvilluar në harmoni me dokumentacionin ndërtimor/projektin ideor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shtëpi banimi individual mund të përdoret.

Bazuar në nenin 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim dhe dispozitat e nenit 12 të Udhëzimit Administrativ MMPH Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, ku thuhet se lëshimi i certifikatës së përdorimit mund të bëhet nëse kërkesat nga Ligji për Ndërtim nr. 04/L-110, janë plotësuar, organi kompetent lëshon certifikatën e përdorimit brenda kohës së caktuar.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe në raportet e prezantuara-bashkangjitura në kërkesë, kjo drejtori konstatoi që ndërtesa shtëpi banimi individual mund të përdoret, gjegjësisht vendosi të lëshojë certifikatën e përdorimit për ndërtesën shtëpi e banimit individual.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certifikatë, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI-ja

Ky vendim u printua në 6 (gjashtë) kopje identike dhe i dërgohet: Kërkuesit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, **Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.**

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,

05 NR. 391/02-75131/25 DT. 14.07.2025

Zyrtari,
Berim Osmanaj

